



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 55 regjistër (JR)

Datë 24.11.2023

Nr. 75 i vendimit

Datë 28.10.2025

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Mimoza Tasi	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 28.10.2025, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 704, datë 09.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimi Elidon Hysenaj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seanca gjyqësore publike të zhvilluara në datat 23.09.2025, 06.10.2025, 13.10.2025, 24.10.2025 dhe 28.10.2025, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet e ngritura në ankim nga Komisioneri Publik Florian Ballhysa i cili kërkoi në mënyrë alternative, ndryshimin e vendimit nr. 704, datë 09.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose lënien në fuqi të këtij vendimi, bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i cili përfundimisht kërkoi lënien në

fuqi të vendimit objekt ankimi, parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoji gjyqtaren relatore Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Elidon Hysenaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Prokuroria e Përgjithshme.

2.1 ILDKPKI-ja dërgoi pranë Komisionit raportin përfundimtar për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka dokumentacion justifikues ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

2.2 DSIK-ja, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës të subjektit të rivlerësimit, ka përcjellë raportin e vlerësimit të përditësuar¹ për subjektin e rivlerësimit me konstatim përfundimtar, papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

2.3 Prokuroria e Përgjithshme² kreu vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në formularin e vetëdeklarimit dhe dokumentet që shoqërojnë atë, 3 (tri) dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 (pesë) dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe në të dhënat nga burimet arkivore të 23 prokurorive të rretheve gjyqësore dhe të Prokurorisë së Përgjithshme. Në përfundim të procesit të kontrollit, i dërgoi Komisionit një raport³ të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të kryer për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale dhe vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të

¹ Raporti i datës 13.10.2022, deklasifikuar pjesërisht, me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 18.11.2022.

² Në cilësinë e organit ndihmës të institucioneve të rivlerësimit, deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me vendimin nr. {***}, datë 19.12.2018, të KLP-së.

³ Raporti nr. {***} prot., datë 23.07.2018.

rivlerësimit. Ky vendim u bazua në konkluzionet përfundimtare të mbërritura për secilin kriter vlerësimi, përmbledhur në vijim.

a. Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm *në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë*, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm, burimin financiar për të gjitha pasuritë e analizuar. Balanca negative prej (-) 401.740 lekësh në vitin 2016 që rezultoi në analizën financiare të përditësuar, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit, nuk mund ta kualifikojë subjektin në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk mund të përbëjë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

b. Subjekti ka arritur nivel të besueshëm *në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës*. Indiciet e organeve ligjzbatuese u vlerësuan se nuk janë në pajtueshmëri të dukshme me provat që rezultuan gjatë hetimit administrativ. Indiciet e mbledhura, parë në raport me veprimet procedurale hetimore konkrete të subjektit të rivlerësimit për çështjet objekt shqyrtimi, nuk përmbajnë të dhëna të nevojshme për të vlerësuar se ka rrethana që krijojnë bindjen se subjekti, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te drejtësia. Nga këto të dhëna, nuk mund të konkludohet për shkelje ligjore që mund të kualifikohen brenda nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, apo që përbëjnë mangësi profesionale.

c. *Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues të kërkuar nga neni 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Komisioni nuk ka konstatuar shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore e serioze në lidhje me kryerjen dhe drejtimin e hetimeve apo vendimmarrjen nga ana e tij dhe as mangësi me peshë evidente në aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

4. Komisioneri Publik Florian Ballhysa ushtroi ankim kundër vendimit nr. 704, datë 09.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke kërkuar në mënyrë alternative, ndryshimin e vendimit ose lënien në fuqi të këtij vendimi. Ankuesi pretendon se, referuar gjendjes së fakteve dhe provave të administruara në fashikullin e Komisionit, nuk vlerëson dot nëse subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë. Konkretisht potencon se:

4.1. Në vendimin objekt ankimi, pothuaj të gjitha problematikat e konstatuara në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, janë prezantuar nëpërmjet informacioneve të organeve ligjzbatuese, në të cilat ankuesi nuk ka akses. Komisioneri Publik ka ardhur në dijeni vetëm mbi përmbajtjen e plotë të raportit të përditësuar të DSIK-së, por jo të informacionit të institucioneve informuese burimore mbi të cilin është bazuar ky raport. Mungesa e aksesit i pamundëson njohjen me informacionin e klasifikuar. Ankuesi kërkon të rivendosë në vëmendje të Kolegjit, dosjet penale të trajtuara nga Komisioni në këtë vendim, në kuadër të vlerësimit të njëkohshëm të profesionalizmit me kontrollin e figurës, pasi mund të marrin kuptim e tjetër peshë, në konsideratë të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese. Për sa më sipër, Komisioneri Publik e ka të pamundur të vlerësojë nëse ka problematika që afektojnë kriterin e integritetit të subjektit të rivlerësimit, që konkludojnë në cenimin e besimit të publikut sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik parashtron nevojën për verifikimin në burim të përmbajtjes së këtyre informacioneve, trajtimin procedural të tyre dhe krahasimin eventualisht me praktikën e administruara, për sa kohë që aktet në dosje nuk japin të dhëna që mund të analizoheshin dhe të mundësonin mbajtjen e një qëndrimi rreth

këtij kriteri. Vetëm në këto rrethana, gjetjet në rastet e trajtuara nga Komisioni, nën dritën e informacionit të klasifikuar si sekret shtetëror, do të krijojnë një panoramë të plotë të kontrollit të besueshmërisë për konfirmimin ose jo në detyrë, të subjektit të rivlerësimit. Komisioneri Publik ka parashtruar shkaqe ankimi në lidhje me gjashtë (6) dosje penale⁴ të administruara si rezultat i informacionit të organeve ligjzbatuese, të shqyrtuara në drejtim të kontrollit të kriterit të figurës, si edhe për dy (2) denoncime⁵ nga publiku, të cilat janë shqyrtuar në drejtim të kontrollit të kriterit të vlerësimit profesional. Në mënyrë konkrete, Komisioneri Publik potencon si vijon.

4.1.1. Sa i përket procedimit penal nr. {***}, datë 05.08.2018⁶, Komisioneri Publik nuk e gjen të argumentuar qartë nevojën për pranimin në seancë gjyqësore të kërkesës së të dyshuarit F. G. për ndryshimin e masës së sigurimit. Komisioneri Publik e referon këtë rast për vlerësim nga Kolegji, duke mos pasur akses në informacionin e klasifikuar që ia pamundëson verifikimin nëse ndryshimi i masës së sigurimit ngre dyshime për përfshirje të subjektit në një episod të papërshtatshëm në drejtim të ushtrimit të detyrës;

4.1.2. Për procedimin penal nr. {***}, datë 23.01.2017, me të pandehur S. H., Komisioneri Publik potencon se të dhënat e kësaj çështjeje penale janë të identifikueshme në raportin e përditësuar të DSIK-së të datës 13.10.2022. Nisur nga çështja e referuar në këtë raport, duket se në rastin konkret ekzistojnë elemente të nevojshme për t'u çmuar nga Kolegji, në drejtim të aplikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

4.1.3. Për procedimin penal nr. {***}, datë 04.12.2018, me të pandehur O. M., ankuesi e vlerëson të paargumentuar dakordësinë e subjektit për ndryshimin e masës së sigurisë gjatë seancës, sipas kërkesave të palës. Në pamundësi të aksesimit të informacionit të klasifikuar që ka shërbyer si indicie për shqyrtimin e kësaj dosjeje, Komisioneri Publik nuk mund të identifikojë nëse subjekti është përfshirë në një episod të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës dhe i kërkon Kolegjit ta marrë në shqyrtim në raport me informacionin e klasifikuar.

4.1.4. Për procedimin penal nr. {***}/2017, me të pandehur L. M., akuzuar për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, me gjendjen e akteve që administrohen në dosjen e Komisionit dhe në pamundësi të aksesimit të informacionit të klasifikuar dhe arsyes që ka shërbyer si indicie për shqyrtimin e kësaj dosjeje, Komisioneri Publik e ka të pamundur të vlerësojë nëse rasti konkret ngre dyshime për përfshirje të subjektit në një episod të papërshtatshëm në drejtim të ushtrimit të detyrës dhe mund të ketë rrethana për t'u vlerësuar sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

4.1.5. Sa i përket procedimit penal nr. {***}/2016 [pa autor – i pezulluar], për veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike”, pretendohet nga ankuesi se të dhënat e kësaj çështjeje penale janë të identifikueshme në raportin e përditësuar të DSIK-së, por në gjendjen që janë aktet dhe në mungesë të ecurisë dhe veprimeve hetimore lidhur me këtë çështje, nuk vlerëson dot nëse rasti konkret ngre

⁴ Çështjet penale me palë, sipas rastit, kallëzues/të pandehur/të dyshuar/viktima, personat: (i) F.G.; (ii) O. M.; (iii) S. H.; (iv) L. M.; (v) S. N.; dhe (vi) H. S..

⁵ Denoncimet e z. A. K. dhe z. E. B..

⁶ Me të dyshuar personat F. G. dhe K. H..

dyshime për përfshirje të subjektit në një episod të papërshtatshëm në drejtim të ushtrimit të detyrës dhe mund të ketë rrethana për t'u vlerësuar sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

4.1.6. Lidhur me materialin kallëzues nr. {***}, datë 25.05.2020, të Komisarariatit të Policisë Sarandë, për veprën penale “Vjedhje me dhunë”, Komisioneri Publik – me gjendjen e akteve që administrohen në dosjen e Komisionit dhe në pamundësi të aksesimit të informacionit të klasifikuar dhe arsyes që ka shërbyer si indicie për shqyrtimin e kësaj dosjeje – nuk vlerëson dot nëse rasti konkret ngre dyshime për përfshirje të subjektit në një episod të papërshtatshëm në drejtim të ushtrimit të detyrës dhe mund të ketë rrethana për t'u vlerësuar sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

4.1.7. Komisioneri Publik i vlerëson pretendimet e denoncuesit A. K.⁷ si të mbështetura nga rezultatet e hetimit. Moskryerja e veprimeve hetimore të nevojshme dhe arsyetimet e pabazuara të subjektit të rivlerësimit për pushimin e çështjes, e konfirmuar në dy raste edhe nga kontrolli gjyqësor, duket se afekton kriterin e aftësisë profesionale sipas nënindikatorëve të parashikuar prej nenit 73, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016. Komisioneri Publik i kërkon Kolegjit t'i trajtojë problematikat e konstatuara në rastin konkret, eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

4.1.8. Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e denoncuesit E. B.⁸ kanë rezultuar të mbështetura nga rezultatet e hetimit. Sipas tij, moskryerja e veprimeve hetimore të nevojshme dhe arsyetimet e pabazuara të subjektit të rivlerësimit për pushimin apo mosfillimin e çështjes, janë konfirmuar në dy raste edhe nga kontrolli gjyqësor. Këto rrethana, në vlerësimin e Komisionerit Publik, duket se afektojnë kriterin e aftësisë profesionale sipas nënindikatorëve të parashikuar prej nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016. Komisioneri Publik i kërkon Kolegjit t'i trajtojë problematikat e konstatuara në rastin konkret, eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Pretendimet e palëve gjatë gjykimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

5. Përpara zhvillimit të seancës gjyqësore publike të datës 23.09.2025, në Kolegj u depozituan tri (3) denoncime nga publiku⁹, si edhe parashtrime dhe akte përkatësisht nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme¹⁰ dhe nga subjekti i rivlerësimit¹¹. Aktet e depozituara në Kolegj, iu njoftuan respektivisht Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar.

⁷ Denoncimi nr. {***} prot., datë 14.01.2019.

⁸ Denoncimi nr. {***} prot., datë 30.06.2022.

⁹ Denoncimi i znj. M. B., përcjellë me e-mail-in e datës 08.01.2024; denoncimi i znj. S. M. (D.), datë 12.09.2025 dhe denoncimi i z. D. G., datë 12.09.2025.

¹⁰ Njëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 18.09.2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme depozitoi parashtrime me shkrim dhe autorizimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, datë 17.09.2025, për përfaqësimin e çështjes në seancë publike nga prokurori Klodjan Braho. (ii) Njëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 17.09.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, u përcoll denoncimi i znj. S. M. (D.).

¹¹ Në datën 11.09.2025, subjekti i rivlerësimit depozitoi fillimisht me postë elektronike dhe më pas dorazi (fizikisht dhe me CD), parashtrime dhe aktet e listuara si vijojnë: (i) material kallëzues nr. {***}, viti 2016, i A. K.; (ii) kopje aktesh E. B.; (iii) kopje të akteve të procedimit penal nr. {***}, viti 2018, me të pandehur F. G. dhe K. H.; (iv) material kallëzues nr. {***}, viti 2020, “Vjedhje me dhunë”, me kallëzues H. S. e të kallëzuar M. A.; (v) procedimi penal nr. {***} i vitit 2017, me të pandehur L. M.; (vi) procedimi penal nr. {***}/2016, “Vjedhja e energjisë elektrike”, pa autor, i pezulluar;

5.1. Në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme iu qëndroi të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e datës 14.11.2023 të Komisionerit Publik (përmbledhur në paragrafët më sipër). Në kushtet që Komisioneri Publik nuk ka pasur akses mbi informacionin e disponuar prej institucionit informues burimor dhe në gjendjen që janë aktet në dosje, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme çmon se pamundësohet vlerësimi nëse në vendimin e Komisionit gjenden mjaftueshëm elemente për të identifikuar dhe vlerësuar drejt, rezultatet e hetimit administrativ të cilat e kanë çuar Komisionin drejt konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Për të njëjtat rrethana, pamundësohet vlerësimi nëse ka problematika që afektojnë kriterin e integritetit të subjektit të rivlerësimit në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që konkludojnë në cenimin e besimit të publikut sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Me pretendimin se, referuar gjendjes së fakteve dhe provave të administruara në fashikull, nuk vlerëson dot nëse subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i kërkon Kolegjit që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe të vendosë në mënyrë alternative, ndryshimin e vendimit të Komisionit ose lënien në fuqi të këtij vendimi.

5.2. Në parashtrimet e para, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar shkaqet ankimore të Komisionerit Publik, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur si vijon.

5.2.1. Për procedimin penal nr. {***}, datë 05.08.2018, me të dyshuar personat F. G. dhe K. H., kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit, e cila është depozituar nga ana e personit nën hetim F. G., ka qenë e bazuar për shkak se në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, rrethanat e faktit ishin zbehur.

5.2.2. Për procedimin penal nr. {***} datë 23.01.2017, me person nën hetim S. H., subjekti i rivlerësimit pretendon se në kërkesën e parë të datës 23.01.2017, ai ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në burg” për shkak se: (i) masa e sigurimit ishte udhëzuar me shkrim nga Drejtuesi i Prokurorisë; (ii) në atë moment procedural, ekzistonin dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprave penale, pasi mungonte një ndër provat thelbësore e konkretisht akti i ekspertimit teknik, i cili deri në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk ishte administruar ende. Sipas subjektit të rivlerësimit, qëndrimi i tij nuk ka ndryshuar mbi të njëjtat akte, por mbi bazën e provave të reja të paraqitura në gjykim e konkretisht, mbi bazën e aktit të ekspertimit teknik që u administrua në datën 24.01.2017, gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore. Bazuar në të dhënat e rezultuara nga kjo provë shkencore e administruar gjatë seancës gjyqësore, masa e sigurimit “Arrest në burg” u vlerësua prej subjektit si joproporcionale në raport me rrethanat e faktit penal. Në të njëjtin konkluzion mbërriti edhe prokurori që ndoqi hetimet pas transferimit të subjektit në një tjetër prokurori, duke vendosur pushimin e çështjes me arsyetimin se aktet e grumbulluara nga hetimet, nuk arrijnë të krijojnë përgjegjësi penale e të provojnë fajësinë e personit nën hetim.

5.2.3. Në lidhje me procedimin penal nr. {***} datë 04.12.2018, me të pandehur O. M., subjekti e konsideron të pavërtetë pretendimin e Komisionerit Publik për dakordësinë e subjektit për ndryshim të masës së sigurimit të dhënë gjatë seancës. Sipas tij, Komisioneri Publik ka keqkuptuar procedurën

(vi) procedimi penal nr. {***} i vitit 2018, me të pandehur O. M.; (vii) procedimi penal nr. {***} i vitit 2017, me person nën hetim S. H.. Në vijim, në datën 18.09.2025, subjekti depozitoi parashtrimet e dyta dhe fashikujt penalë në lidhje me tri denoncimet e njoftuara nga Kolegji.

e gjykimit të drejtpërdrejtë, duke konsideruar si ndryshim mase sigurimi, dakordësinë e tij për konvertimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë. Subjekti sqaron se, nga ana e tij, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për ndryshim mase sigurimi. Gjithashtu, në bazë të nenit 291/2 të Kodit të Procedurës Penale, konvertimi i dënimit është atribut i gjykatës dhe jo i prokurorit. Kjo është një praktikë e zakonshme e prokurorisë dhe e gjykatës, e cila në të gjitha rastet e ngjashme ka zëvendësuar dënimin me burgim me dënim me gjobë¹².

5.2.4. Për procedimin penal nr. {***}, datë 04.12.2018, me të pandehur L. M., subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioneri Publik është i paqartë mbi arsyen e ankimimit të këtij procedimi penal. Qëndrimi i subjektit ka qenë në përputhje me ligjin. Meqenëse fakti penal ka qenë i qartë dhe provat të plota, është proceduar me gjykim të drejtpërdrejtë. Kërkesa për aplikimin e dënimit alternativ “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” bazohet në rrethanat e parashikuara në nenin 59 të Kodit Penal e, për rrjedhojë, është në përputhje me këtë dispozitë.

5.2.5. Sa i përket procedimit penal nr. {***}/2016 (pa autor – i pezulluar), për veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit, pasi ka prezantuar edhe një herë panoramën e hetimeve të kryera prej tij në funksion të këtij procedimi penal, pretendon se vendimi i pezullimit nuk është vendim përfundimtar dhe, si tillë, nuk mund të konsiderohet si zgjidhje favorizuese për palën.

5.2.6. Lidhur me materialin kallëzues nr. {***}, datë 25.5.2020, të Komisarariatit të Policisë Sarandë, për veprën penale “Vjedhje me dhunë”, subjekti pretendon se ka kryer hetime të plota të cilat, sipas tij, provuan se fakti i ndodhur nuk përmbante elemente të veprës penale “Vjedhje me dhunë”, të referuar nga policia. Shkaku i ngjarjes ishte një konflikt për shkaqe personale dhe jo vjedhja. Nga hetimet, rezultoi se ishte kryer vetëm vepra penale “Dëmtime të tjera me dashje”, e cila, në bazë të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, procedohet në gjykatë jo nga prokurori, por nga vetë i dëmtuari akuzues.

5.2.7. Në prapësim të shkakut ankimor që i përket denoncimit të z. A. K., subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) denoncimi është bërë në vitin 2019 dhe nuk ngre pretendime për veprimtarinë hetimore të subjektit, e cila konsiston vetëm në vendimin e mosfillimit, pasi prej vitit 2017, të komandimit të subjektit në prokurorinë Vlorë, hetimet për këtë çështje penale, ndiqeshin nga një tjetër prokuror; (ii) veprimtaria hetimore në rastin konkret është trajtuar edhe nga ILD-ja, e cila ka vendosur arkivimin e ankesës. Në vendimin e ILD-së, subjekti është cilësuar gabimisht si prokurori që ka hetuar çështjen, për shkak të informacionit të gabuar që ka dërguar Prokuroria Sarandë; (iii) vendimi i mosfillimit nuk është marrë apriori, por pasi janë kryer veprimet e duhura verifikuese, të cilat i krijuan bindjen se fakti i kallëzuar nuk përbënte vepër penale. Ky fakt është konstatuar edhe nga Prokuroria e Posaçme, e cila ka arritur në të njëjtin përfundim duke kërkuar pushimin e çështjes penale¹³.

5.2.8. Në prapësim të shkakut ankimor për denoncimin e z. E. B., subjekti pretendon se: (i) kthimi i akteve nga gjykata për kryerje të hetimeve shtesë, është një praktikë e zakonshme që shoqëron punën

¹² Subjekti ka depozituar në Kolegj, gjashtë (6) vendime për të tjera procedime penale, me të tjerë të pandehur, për të njëjtin lloj vepre penale, të ndjekura po nga subjekti i rivlerësimit.

¹³ Subjekti ka depozituar në Kolegj, shkresën datë 01.08.2025 të Prokurorisë së Posaçme, përmes së cilës i është vënë në dispozicion kërkesa për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2022, duke i konfirmuar gjithashtu se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin e kërkesës, por se nuk e disponon ende kopjen e zbardhur të këtij vendimi.

e një prokurori dhe nuk do të thotë apriori se prokurori ka kryer ndonjë shkelje. Pretendimi për shkelje të procedurave të hetimit penal, do të kishte logjikë vetëm në rastet kur gjykata që shqyrton veprimtarinë hetimore të prokurorit, konstaton shkelje procedurale apo zbatim të gabuar të ligjit, të konfirmuara këto edhe nga një gjykatë më e lartë; (ii) në rastin konkret, ka qenë vullneti i subjektit të rivlerësimit për të kthyer aktet, meqenëse dolën fakte të reja gjatë gjykimit të kërkesës për pushim. Për të njëjtën arsye, vendimi i gjykatës nuk u ankimua prej tij.

5.2.9. Në parashtrimet e dyta të datës 18.09.2025, subjekti ka dhënë shpjegime dhe depozitoi akte në lidhje me tri denoncimet e paraqitura në Kolegj e konkretisht për denoncimin e z. D. G., atë të paraqitur nga znj. S. M. (D.), si edhe për denoncimin e znj. M. B. dhe znj. A. Q. ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, ndër to edhe ndaj subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka pretenduar se në të gjitha procedimet penale të denoncuara, ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore penale, qofshin ato procedurale dhe materiale.

V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Mbi procesin gjyqësor në Kolegj*

A/i. *Juridiksioni i Kolegjit*

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja me objekt shqyrtimi kundërshtimin e vendimit të Komisionit bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit, me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është rezultat i shortit të zhvilluar në datën 06.12.2023, i cili është publikuar në internet në faqen zyrtare të Kolegjit.

A/ii. *Legjitimimi i ankuesit*

7. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

A/iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

8. Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 704, datë 09.10.2023, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike, në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
9. Në seancën gjyqësore të datës 23.09.2025, për shkak të mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë dhe bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe të nenit 199, paragrafi i 2-të i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit deklaroi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ky i fundit, në bazë të autorizimit të datës 17.09.2025, u përfaqësua nga prokurori Klodjan Braho.

9.1. Në këtë seancë gjyqësore, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, prezantoi në mënyrë të përmbledhur parashtrimet e paraqitura me shkrim, në të cilat u qëndroi të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e datës 14.11.2023 të Komisionerit Publik (përmbledhur në paragrafët më sipër). Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kërkoi që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe të vendosë në mënyrë alternative, ndryshimin e vendimit nr. 704, datë 09.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose lënien në fuqi të këtij vendimi, në varësi të rezultateve dhe të provave që do të administrohen gjatë shqyrtimit gjyqësor.

9.2. Edhe subjekti i rivlerësimit prezantoi në mënyrë të përmbledhur parashtrimet e paraqitura me shkrim, përmbledhur në paragrafët më lart. Ai parashtrroi se shkaqet e ankimit janë të pabazuara në ligj dhe në prova, të paargumentuara, joracionale dhe në mospërputhje me dispozitat e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti kërkoi mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.

9.3. Pasi u pyetën në lidhje me tri (3) denoncimet e depozituara në Kolegj, për të cilat subjekti kishte depozituar në datën 15.09.2025 edhe parashtrime me shkrim e akte, duke kërkuar administrimin e tyre në cilësinë e provës, palët konfirmuan marrjen dijeni. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pasi konfirmoi njohjen me denoncimet, materialet bashkëlidhur dhe me parashtrimet e subjektit, vlerësoi se denoncimet e mësipërme nuk përmbajnë rrethana të tilla që do të ndikojnë në procesin e rivlerësimit për rastin konkret. Përfaqësuesja ligjore e subjektit shprehu dakordësinë me qëndrimin e mbajtur nga ana e përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe shtoi që në rast se do t'i nënshtrohen shqyrtimit në Kolegj, mbajnë të njëjtin qëndrim të parashtruar edhe në parashtrimet shtesë që lidhen me denoncimet përkatëse. Krahas akteve të përcjella me parashtrimet, përfaqësuesja e subjektit kërkoi t'i vërë në dispozicion trupës së Kolegjit edhe shkresën e ardhur nga ana e Prokurorisë së Posaçme, datë 12.09.2025, që ka të bëjë me denoncimin e shtetasit A. K.. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme shprehu dakordësinë për pranimin e të gjitha akteve pa kundërshtime për pranueshmërinë e tyre, ndërsa rezervoi të drejtën për t'u shprehur në bisedimet përfundimtare mbi vlerën e tyre provuese.

9.4. Pas tërheqjes në dhomë këshillimi për të diskutuar mbi kërkesat e palëve, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, vendosi: (i) të çelë hetimin gjyqësor dhe të pranojë në cilësinë e provës, aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit dhe shkresën e saposjellë prej tij nga Prokuroria e Posaçme me numër protokolli {***}, datë 12.09.2025; (ii) të njihet në mënyrë të drejtpërdrejtë me informacionin e klasifikuar, të njohur edhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në kuadër të kësaj çështjeje, pranë institucioneve ligjzbatuese që e administrojnë atë; (iii) lidhur me denoncimet, trupi gjykues, duke u mbështetur në qëndrimet e palëve për to, nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson që të mos vijojë hetim të mëtejshëm pasi nuk jemi në kushtet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

10. Në seancën gjyqësore publike të datës 06.10.2025, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme parashtrroi bisedimet, në të cilat, ndryshe nga sa ishte parashtruar në ankimin e Komisionerit Publik apo edhe në parashtrimet e paraqitura në seancën gjyqësore publike të datës 23.09.2025, pretendoi se pas njohjes me provat e reja për dosjet e ankimuara, vijon të mbetet e paargumentuar dhe e paqartë ndërmarrja e veprimeve hetimore prej subjektit të rivlerësimit për disa prej tyre. Konkretisht:

10.1. Mbeti i paqartë dhe i paargumentuar ndryshimi i qëndrimit/dakordësia e subjektit në drejtim të ndryshimit të masës së sigurimit gjatë seancave gjyqësore në tri procedime penale: (i) nr. {***}/2018, me të pandehur F. G. dhe K. H.; (ii) nr. {***}/2017, me të pandehur S. H.; dhe (iii) nr. {***}/2018, në ngarkim të të pandehurit O. M.. Rrethanat e konstatuara në këto procedime penale, duhen vlerësuar nga Kolegji sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të aplikimit të nenit 61, pika 5 e po këtij ligji, parë në raport dhe me informacionin e klasifikuar me të cilin Kolegji u njoh në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë institucioneve ligjzbatuese që e administrojnë atë.

10.2. Lidhur me tri procedimet penale: (i) nr. {***}/2017, në ngarkim të të pandehurit L. M.; (ii) nr. {***}/2016, pa autor, i pezulluar; dhe (iii) nr. {***}/2020, për veprën “Vjedhje me dhunë”, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, pasi shqyrtoi prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo problematika të tjera në trajtimin e këtyre rasteve nga subjekti i rivlerësimit.

10.3. Ndërsa problematikat e trajtuara gjerësisht në ankim dhe në parashtrimet e datës 23.09.2025, në lidhje me dy denoncimet, janë të vlefshme për t’u trajtuar nga Kolegji, së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

10.4. Duke mos pasur akses në informacionin e disponuar prej institucionit informues burimor dhe në kushtet që aktet në dosje nuk japin të dhëna që mund të analizoheshin dhe të mundësonin mbajtjen e një qëndrimi përfundimtar për rastin, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i kërkon Kolegjit që gjetjet e konstatuara në këto parashtrime, të vlerësohen në raport me informacionin e klasifikuar, me të cilin Kolegji është njohur në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë institucioneve ligjzbatuese.

10.5. Në përfundim, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i kërkoi Kolegjit që të marrë në konsideratë gjetjet e konstatuara për këto dosje, t’i vlerësojë ato në raport me informacionin e klasifikuar me të cilin është njohur Kolegji dhe, në mënyrë alternative, të vendosë ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 704, datë 09.10.2023.

10.6. Në vijim të kërkesës së trupit gjykues për të paraqitur një qëndrim përfundimtar dhe joalternativ për çështjen, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deklaroi se vjen me këtë kërkim alternativ, në konsideratë të peshës që ka informacioni dhe burimet e informacionit të agjencive ligjzbatuese, me të cilin nuk janë njohur. Trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, vendosi t’i kërkojë Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe përfaqësuesit të tij me autorizim, të paraqesë një kërkim konkret të vetëm, pa alternativa, për vendimin objekt kontrolli, duke e ftuar që nëse e vlerëson të nevojshme, të aksesojnë për konsultim në ambientet e Kolegjit, dosjen e klasifikuar të subjektit të rivlerësimit, e cila është e administruar në fashikullin e Komisionit, si pjesë përbërëse e tij.

11. Në seancën gjyqësore të datës 13.10.2025, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, u shpreh se, pasi u njoh me aktet në dosjen e klasifikuar të subjektit të rivlerësimit, të administruar në fashikullin e Komisionit si pjesë përbërëse e tij, konstatoi se informacioni që administrohej në të, është i pamjaftueshëm për t’u dhënë zgjidhje tërësisht shkaqeve të ankimit. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i ka kërkuar institucionit ligjzbatues ku ndodhet informacioni, për t’u njohur me atë informacion në burim, por ende nuk është bërë e mundur njohja me informacionin në burim, për shkaqe të pavarura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Në këto kushte, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i kërkoi Kolegjit shtyrjen e seancës gjyqësore për t’u bërë i mundur

realizimi i kësaj procedure dhe për të ardhur me një qëndrim përpara Kolegjit. Kjo kërkesë u pranua nga trupi gjykues dhe seanca e radhës u shty për datën 24.10.2025, për të dëgjuar bisedimet përfundimtare të palëve.

12. Gjatë seancës gjyqësore publike të datës 24.10.2025, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme u shpreh se në datën 15.10.2025, ka aksesuar dhe është njohur në mënyrë të drejtpërdrejtë me informacionin e klasifikuar të disponuar për subjektin e rivlerësimit pranë institucionit informues burimor. Në, bisedimet përfundimtare të depozituara gjatë kësaj seance, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke u bazuar në shpjegimet dhe provat e administruara, si dhe në vlerësim të informacioneve të klasifikuara të aksesuara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, duke vlerësuar vlerën burimore dhe saktësinë e tyre, çmon se gjetjet dhe problematikat e evidentuara nuk përbëjnë shkelje të rënda apo mangësi profesionale të tilla që të justifikojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe kërkoi përfundimisht *lënien në fuqi* të vendimit të Komisionit. Në bisedimet e tij përfundimtare, subjekti i rivlerësimit e vlerësoi të drejtë qëndrimin përfundimtar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe kërkoi përfundimisht *lënien në fuqi* të vendimit objekt shqyrtimi.

B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

13. Pasi analizoi konkluzionet përfundimtare të palëve, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit vlerëson se në kushtet kur Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si i vetmi disponues i mjetit procedural të ankimit, ka kërkuar *lënien në fuqi* të vendimit të Komisionit, duke mos e kundërshtuar më atë, rezulton se nuk ekzistojnë më arsye faktike dhe ligjore për ndryshimin e vendimit të ankimit. Si rrjedhojë, ankimi mbetet pa objekt. Në vlerësim të trupit gjykues, kjo situatë përbën në thelb një sjellje procedurale që barazohet për nga efektet me atë të heqjes dorë nga ankimi, sipas kuptimit të dhënë nga legjislatori për këtë institut procedural të parashikuar në nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile. Në vijim të këtij arsytimi, në rrethanat që deduktohet mungesë e interesit të ligjshëm, një vendimmarrje e Kolegjit e ndryshme nga ajo e kërkuar nga ankuesi, teorikisht do ta bënte vendimin të cenueshëm, nëse do të ankimohej nga subjekti i rivlerësimit. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nuk kishte më lëndë procedurale për të vijuar kontrollin gjyqësor të vendimit objekt shqyrtimi.
14. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pasoja e vetme ligjore për këtë situatë faktike procedurale, është *pushimi i shqyrtimit* në Kolegjin të çështjes së juridiksionit të rivlerësimit me nr. 55/2023, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Elidon Hysenaj, pasi vijimi i gjykimit për kontrollin e vendimit të Komisionit mbi bazën e një ankimi, të mbetur pa objekt dhe në mungesë të interesit të ligjshëm të ankuesit, do të përbënte cenim të procesit të rregullt ligjor.
15. Në funksion të qartësimit të pozitës procedurale të subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, me konsideratë natyrën *sui generis* të këtij procesi, trupi gjykues i Kolegjit gjen të nevojshëm të deklarojë efektin ligjor që prodhon kjo vendimmarrje në raport me vendimin e Komisionit, objekt i ankimit të Komisionit Publik. Në këtë kuptim, në zbatim të parashikimeve të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, neneve 1, pika 2 dhe 44 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe neneve 451, shkronja “b” dhe 463 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi nr. 704, datë

09.10.2023, i Komisionit, ndaj të cilit është ushtruar ankimi, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në nenet 451, shkronja “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 55/2023 që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 704, datë 09.10.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Elidon Hysenaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 28.10.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Mimoza TASI

nënshkrimi